



Planuar / Doretuar Punëjeto/Proizato Received/Delivary	29.08.2022	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot In Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHA	5003/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.598/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci – Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.598/2022 të datës 06.07.2022 të parashtruar nga ankuesi

me adresë: Komuna e Pejës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 29.08.2022 mori këtë:

V E N D I M

**HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.598/2022 e datës 06.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, sipas Akt emërimit të datës 04.09.2011 në pozitën “Ekzaminer”, në Njësinë e Patentë Shoferëve në Pejë, në kuadër të Departamentit për Patentë Shofer, me datë 04.04.2022 përmes emalit zyrtare ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Divizionit për Pyetës në Departamentin për Patentë Shofer, për lejimin e ushtrimit të detyrave të punës të pyetësit-Ekzaminerit. Me datë 07.04.2022 dhe 09.06.2022 ankuesi ka pranuar përgjigje nga Drejtori i Departamentit për Patentë Shofer në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, i cili i është referuar dispozitave të nenit 3 dhe nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.08/2016 për Pyetës.

Ankuesi kundër mos lejimit të ushtrimit të detyrave të punës sipas Akt emërimit të datës 04.09.2011 për pozitën Pyetës-Ekzaminer, me datë 06.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me numër protokollit 3932/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 25.07.2022 ka

dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, ndërsa Këshilli me datë 03.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës prej 1/23 faqe.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.08.2022 ka nxjerrë Vendimin me VK.nr.83/2022 për vazhdimin e afatit të ankesës me numër Anr.598/2022 të datë 06.07.2022, edhe për 10 dite pune .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me qëllim të vendosjes meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 06.07.2022 me numër protokoli 3932/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 04.04.2022; E-mail i datës 07.04.2022; E-mail i datës 14.04.2022; E-mail i datës 15.04.2022; Shkresë e datës 11.05.2022 nga ankuesi; Përgjigje e datës 09.06.2022; kërkesë e datës 14.06.2022 nga ankuesi; Akte emërimi i datës 04.09.2011; Përgjigje në kërkesë e datës 03.08.2022; Përshkrimi i detyrave të punës; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit i datës 25.08.2016; E-mail i datës 29.08.2016; E-mail i datës 21.09.2016; Arsyetim i vendimit për transferim i datës 11.03.2016; Vendim i datës 08.04.2016 me nr. Protokoli 1717; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë i datës 06.01.2021; Udhëzimi Administrativ (MI) Nr.08/16 për Pyetës i datës 30.12.2016 me numër protokoli 37418.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit , është e **palejuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi në ankesën e datës 06.07.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me numër protokoli 3932/2022 ka pretenduar që ti bëhet lejimi i ushtrimit të detyrave të punës sipas Akt emërimit të datës 04.09.2011 në pozitën Pyetës-Ekzaminer dhe lidhur me këtë i njëjti ka parashtruar kërkesë me datë 04.04.2022 përmes e-mailit zyrtar tek Udhëheqësi i Divizionit për Pyetës në Departamentin për Patentë Shofer, ndërsa me datë 07.04.2022 dhe 09.06.2022 ankuesi ka pranuar përgjigje nga Drejtori i Departamentit për Patentë Shofer në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, i cili i është referuar dispozitave të nenit 3 dhe nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.08/2016 për Pyetës.

Kolegji i Këshillit në vështrim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në këtë kuptim si dhe referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..."*, Kolegji i Këshillit vlerëson se me e-mailat gjegjësisht përgjigjet e datës 07.04.2022 dhe 09.06.2022 të Drejtorit të Departamentit për Patentë Shofer në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit i cili është i përcaktuar në mënyrë specifike lidhur me marrëdhënien e tij të punës e përcaktuar sipas Aktit të Emërimit të nënshkruar të datës 04.09.2011, andaj bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesi e datës 06.07.2022 është e paqëndrueshme dhe



si e tillë hedhet poshtë si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që pozita dhe të drejtat që burojnë nga akti i përhershëm i themelimit të marrëdhënies së punës gjegjësisht paga nuk i janë cenuar, po ashtu sipas dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.08/2016 për Pyetës është në diskrecion të Ministrit të caktoje kohëzgjatjen e angazhimit të pyetësit për mbajtjen e provimit teorik dhe praktik për patentë shofer, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa me numër A.nr.598/2022 e datës 06.07.2022, e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me A.nr.598/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

MALSORE GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë;
- Arkivit të KPMSHCK- së.